

| | |
|---|--|
| RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | |
| EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS | Për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar për Artin” |
| MINISTRIA UDHËHEQËSE | Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit |
| FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | Finale |
| BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS | I brendshëm |
| DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së | Direktiva / Jo e zbatueshme |
| PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA | Programi i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë 2025–2029; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025; Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030; Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 |
| DATA E KONSULTIMIT PUBLIK | 31.03.2026 – 28.04.2026 |
| DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | 01/06/2026 |
| A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT | Po/Jo 20/04/2026 |
| NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT | 2026 – MTKS – Nr. 2 |
| TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT) | |
| PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe) | |
| PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT | |
| <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 7 rreshta)</i> | |
| <p>Sektori i artit dhe kulturës në Republikën e Shqipërisë karakterizohet nga mungesa e një mekanizmi të dedikuar financiar dhe institucional që të mundësojë investime strategjike në art, pasurimin sistematik të koleksioneve publike dhe ndërhyrje të shpejta në tregun e artit. Financimi aktual mbështetet kryesisht në alokime buxhetore vjetore të orientuara drejt shpenzimeve operative, ndërsa mungojnë instrumentet e posaçme për investime zhvillimore dhe blerje strategjike të veprave me vlerë artistike e kulturore. Procedurat ekzistuese financiare dhe të prokurimit nuk janë të përshtatura me specifikat e tregut të artit, i cili kërkon fleksibilitet dhe reagim të shpejtë. Kjo situatë ka sjellë kapacitete të kufizuara për pasurimin e koleksioneve publike, fragmentim institucional në vendimmarrje dhe mundësi të humbura për sigurimin e veprave me rëndësi kombëtare. Për këto arsye, vlerësohet e nevojshme ndërhyrja e shtetit përmes krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të specializuar financimi në fushën e artit dhe kulturës. Gjithashtu, mungon një burim financiar i dedikuar dhe i qëndrueshëm që të garantojë financimin afatgjatë të politikave publike për pasurimin e koleksioneve kombëtare dhe mbrojtjen e trashëgimisë artistike.</p> | |

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivi i përgjithshëm i propozimit është modernizimi i kuadrit institucional dhe financiar në fushën e artit dhe kulturës, përmes krijimit të një mekanizmi të posaçëm dhe të qëndrueshëm publik që mundëson financimin, pasurimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë artistike dhe kulturore në Republikën e Shqipërisë.

Në funksion të këtij objekti, synohen këto objektiva specifike:

- a) krijimi i një fondi të posaçëm publik, të integruar në sistemin buxhetor të shtetit, për financimin e blerjes dhe administrimit të veprave të artit dhe objekteve me vlerë kulturore;
- b) pasurimi dhe diversifikimi i koleksioneve publike përmes përvetësimit sistematik të veprave me vlerë artistike dhe historike;
- c) forcimi i mekanizmave për mbrojtjen dhe rikthimin e veprave me rëndësi kombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ç) nxitja e krijimtarisë artistike dhe zhvillimi i tregut të artit përmes ndërhyrjeve publike të strukturuar;
- d) rritja e aksesit të publikut në vlerat artistike dhe kulturore nëpërmjet ekspozimit në institucione dhe hapësira publike;
- dh) forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit financiar në administrimin e fondeve publike të dedikuara për kulturën.
- e) krijimi i një mekanizmi të specializuar vendimmarrës me ekspertizë profesionale për vlerësimin, përzgjedhjen dhe administrimin e veprave të artit dhe pasurive kulturore që financohen nga fondi.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij propozimi përfshijnë krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të financimit publik për artin, rritjen e kapacitetit të shtetit për të ndërhyrë në tregun e artit në mënyrë profesionale dhe të shpejtë, si dhe përmirësimin e ndjeshëm të nivelit të pasurisë kulturore në pronësi publike. Gjithashtu, pritet rritja e aksesit të qytetarëve në art dhe kulturë, si dhe forcimi i standardeve të transparencës dhe kontrollit në përdorimin e fondeve publike. Po ashtu, pritet përmirësimi i koordinimit ndër-institucional ndërmjet institucioneve përgjegjëse për kulturën dhe trashëgiminë kulturore, si dhe krijimi i procedurave të specializuara për vlerësimin dhe blerjen e veprave të artit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 0 – Ruajtja e Status Quo-së: vijimi i funksionimit aktual të sektorit të artit dhe kulturës brenda kuadrit ekzistues institucional dhe financiar.

Përfitime: Ky opsion nuk kërkon ndryshime ligjore apo institucionale, si dhe nuk gjeneron kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Kosto/Disavantazhe: Ky opsion sjell mungesën e një mekanizmi të dedikuar për financim strategjik të artit, pamundësi për ndërhyrje të shpejtë në tregun e artit, humbjen e mundësive për pasurimin e koleksioneve publike, si dhe vijimin e fragmentimit institucional dhe mungesës së koordinimit.

Ky opsion nuk adreson problematikat e identifikuara dhe nuk siguron përmirësim të politikës publike në këtë fushë.

Opsioni 1 (jorregullator) – Rritje e financimit brenda skemës ekzistuese buxhetore. Ky opsion parashikon rritjen e alokimeve për kulturën brenda strukturës aktuale të buxhetit të shtetit.

Përfitime: Nëpërmjet këtij opsioni parashikohet të përdoren strukturat ekzistuese institucionale. Për rrjedhojë, mund të kemi rritje të fondeve për sektorin e kulturës në afat të shkurtër.

Kosto/Disavantazhe: Zgjedhja e këtij opsioni do të sillte rritjen e presionit mbi buxhetin e shtetit, mungesë fleksibiliteti në ndërhyrje të caktuara, rrezik të përdorimit jo të targetuar të fondeve, si dhe nuk zgjidh problemin e mungesës së një mekanizmi të dedikuar.

Ky opsion nuk sjell ndryshim strukturor, por vetëm rritje të kufizuar financimi brenda një sistemi ekzistues jo optimal.

Opsioni 2 (opsioni i preferuar) – Krijimi i Fondit Kombëtar për Artin. Ky opsion parashikon krijimin e një fondi të posaçëm publik, të integruar në sistemin buxhetor, i financuar nga një përqindje e kursimeve të prokurimeve publike.

Përfitime: Ky opsion garanton neutralitet fiskal dhe mosrritjen e shpenzimeve të reja buxhetore, krijimin e një burimi të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm financimi, rritje të eficiencës dhe targetimit të shpenzimeve publike në kulturë, forcim të transparencës dhe kontrollit institucional, si dhe mundësi për ndërhyrje të shpejta dhe profesionale në tregun e artit.

Kosto/Disavantazhe: Zgjedhja e këtij opsioni dikton nevojën për koordinim të shtuar ndërinstytucional në fazën e zbatimit, si dhe nevojën për zhvillim të kapaciteteve administrative dhe teknike.

Ky opsion konsiderohet më i përshtatshmi, pasi kombinon qëndrueshmërinë financiare me efikasitetin institucional dhe garanton një mekanizëm të dedikuar për zhvillimin e sektorit.

Opsioni 3 – Skemë hibride përmes PPP dhe donacioneve. Ky opsion bazohet në financim përmes partneriteteve publike-private, donacioneve dhe granteve, pa krijimin e një fondi të strukturuar brenda buxhetit të shtetit.

Përfitime: Ky opsion do të sillte diversifikim të burimeve financiare, rritje të përfshirjes së sektorit privat dhe donatorëve, si dhe fleksibilitet në financimin e projekteve kulturore.

Kosto/Disavantazhe: Zbatimi i këtij opsioni do të sillte mungesë të qëndrueshmërisë financiare afatgjatë, varësi nga interesat e donatorëve, fragmentimin e politikave kulturore, si dhe mungesë koordinimi dhe standardizimi institucional.

Ky opsion nuk garanton stabilitet institucional dhe financiar, duke e bërë të pamjaftueshëm për arritjen e objektivave strategjike të politikës publike në këtë fushë.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 7 rreshta)

Ndikimi ekonomik

Ndikimi ekonomik i opsionit të preferuar vlerësohet pozitiv në afat të mesëm dhe afatgjatë, pasi nuk krijon kosto të reja shtesë për buxhetin e shtetit, por orienton një pjesë të kursimeve ekzistuese nga prokurimet publike drejt sektorit të artit dhe kulturës. Ky mekanizëm pritet të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë kreative dhe të gjenerojë efekte indirekte në sektorë të lidhur, si turizmi kulturor dhe industrinë krijuese.

Ndikimi financiar

Nga pikëpamja financiare, skema e propozuar bazohet në alokimin e 10% të kursimeve të realizuara nga procedurat e prokurimit publik, duke ruajtur neutralitetin fiskal dhe pa ndikuar në rritjen e deficitit apo shpenzimeve totale publike. Mekanizmi synon përmirësimin e eficiencës në përdorimin e fondeve publike, përmes ridrejtimit të kursimeve drejt investimeve në pasuri kulturore me vlerë publike.

Ndikimi social

Në aspektin social, pritet rritje e aksesit të publikut në art dhe kulturë përmes pasurimit të koleksioneve publike dhe ekspozimit të veprave në institucione dhe hapësira publike. Kjo ndërhyrje kontribuon në forcimin e identitetit kulturor, rritjen e ndërgjegjësimit kulturor dhe përmirësimin e kohezionit social, duke e bërë artin më të aksesueshëm për qytetarët.

Ndikimi institucional

Në nivel institucional, nisma forcon kapacitetet e ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe krijon një mekanizëm të qartë vendimmarrës dhe zbatues për administrimin e fondit. Pritet përmirësim i transparencës, rritje e llogaridhënies dhe standardizim i procedurave në blerjen dhe administrimin e veprave të artit.

Ndikimi në sektorin privat dhe biznesin

Nisma krijon mundësi të reja për artistët, galeritë dhe operatorët kulturorë, duke nxitur zhvillimin e tregut të artit dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. Përfshirja e donacioneve dhe sponsorizimeve pritet të rrisë ndërveprimin me aktorët ekonomikë në fushën e kulturës dhe të forcojë ekosistemin e industrive kreative.

Në mënyrë indirekte, pritet të ketë ndikim pozitiv edhe në sektorin e turizmit kulturor, pasi pasurimi i koleksioneve publike dhe rritja e ekspozimit të veprave të artit në institucione dhe hapësira publike rrit atraktivitetin kulturor të vendit. Kjo mund të sjellë rritje të kërkesës për shërbime turistike si akomodimi, transporti, guidat kulturore dhe shërbimet e mikpritjes, duke kontribuar në zhvillimin e bizneseve lokale.

Ndikimi mjedisor

Nisma nuk parashikon ndikime të drejtpërdrejta në mjedis dhe vlerësohet të jetë neutrale nga pikëpamja mjedisore.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Nga analiza me shumë kritere e kryer për të tre opsionet tregohet se opsioni 2, Krijimi i Fondit Kombëtar për Artin, është vlerësuar më me shumë pikë duke u zgjedhur si opsioni i preferuar.

Arsyeja për përzgjedhjen e këtij opsioni është e shpjeguar në mënyrë të mëposhtme:

Opsioni 2 është përzgjedhur si alternativa më e përshtatshme, në bazë të analizës shumëkriterëshe, për shkak të balancës midis qëndrueshmërisë financiare, eficiencës institucionale dhe ndikimit afatgjatë në zhvillimin e sektorit të artit dhe kulturës.

Ky opsion garanton neutralitet fiskal, pasi financohet nga 10% e kursimeve të prokurimeve publike dhe nuk krijon kosto shtesë për buxhetin e shtetit, duke e bërë të zbatueshëm dhe të qëndrueshëm në afat të gjatë.

Përfitimi kryesor qëndron në krijimin e një burimi të dedikuar dhe të parashikueshëm financimi, i cili mundëson planifikim afatgjatë dhe ndërhyrje të shpejtë në tregun e artit për pasurimin e koleksioneve publike dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Nga ana tjetër, opsioni rrit eficiencën në përdorimin e fondeve publike duke kanalizuar kursimet drejt një qëllimi të specializuar dhe të matshëm, duke reduktuar fragmentimin aktual të financimeve.

Gjithashtu, krijimi i një strukture të dedikuar me mekanizma ekspertize dhe transparence rrit cilësinë e vendimmarrjes dhe forcon llogaridhënien publike.

Në aspektin afatgjatë, opsioni pritet të modernizojë qeverisjen e sektorit kulturor dhe të rrisë bashkëpunimin me aktorët privatë, duke e bërë politikën kulturore më efikase dhe të qëndrueshme.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë)

Opsioni i preferuar nuk parashikon kosto shtesë direkte mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare pas miratimit të ligjit, pasi financimi i Fondit Kombëtar për Artin realizohet përmes alokimit të 10% të kursimeve të krijuara nga procedurat e prokurimit publik. Ky mekanizëm bazohet në rishpërndarjen e kursimeve ekzistuese dhe nuk krijon shpenzime të reja buxhetore. Për rrjedhojë, ndikimi neto në buxhetin e shtetit vlerësohet zero (0) në terma nominalë për periudhën e analizuar.

| Viti <u>1</u> | Viti <u>2</u> | Viti <u>3</u> |
|---------------|---------------|---------------|
| 0 | 0 | 0 |

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta - te plotësohet nese eshte kryer konsultimi publik)

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) për një periudhë 20 (njëzet) ditë pune, nga data 31 mars 2026 deri më 28 prill 2026. Gjatë kësaj periudhe nuk janë

paraqitur komente apo sugjerime nga palët e interesuara, as në platformë dhe as në adresat elektronike të vëna në dispozicion. Projektligji ka pasur 165 shikime në RENJKP.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Zbatimi i opsionit të preferuar (krijimi i Fondit Kombëtar për Artin) do të fillojë pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe do të vijojë me miratimin e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave. Këto akte do të përcaktojnë organizimin institucional, ndarjen e kompetencave dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse, përfshirë Komisionin e ekspertëve dhe sekretariatit teknik.

Monitorimi i zbatimit do të kryhet nga Ministria përgjegjëse për kulturën në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe institucionet e auditimit publik, përmes raportimit periodik dhe kontrollit financiar. Ky proces siguron transparencë, eficiencë dhe llogaridhënie në administrimin e fondit.

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Aktualisht, fusha e artit dhe trashëgimisë kulturore në Shqipëri rregullohet nga një kuadër ligjor dhe nënligjor i fragmentuar, i cili kombinon dispozita për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me mekanizma të ndryshëm të financimit publik të kulturës. Ky kuadër garanton administrimin dhe ruajtjen e pasurive kulturore, por nuk krijon një instrument të dedikuar financiar për ndërhyrje strategjike në tregun e artit dhe kulturës, për pasurimin sistematik të koleksioneve publike.

Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar përcakton rregullat për identifikimin, mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e pasurive kulturore, duke e orientuar sistemin kryesisht drejt konservimit dhe administrimit të trashëgimisë ekzistuese, pa parashikuar mekanizma fleksibël për blerje strategjike në tregun e artit.

Ndërkohë, funksionimi i financimit kulturor dhe ndërhyrjeve publike në art mbështetet në disa akte nënligjore specifike. Vendimi nr. 24, datë 16.01.2019, i Këshillit të Ministrave Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit” krijon një mekanizëm të dedikuar për financimin e projekteve në fushën e librit dhe promovimit të leximit përmes Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit. Vendimi nr. 510, datë 18.07.2012, i Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor” mundëson financimin dhe realizimin e veprave monumentale të artit pamor përmes konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u fokusuar në artin publik dhe ndërhyrjet monumentale në hapësirën publike.

Në sektorin muzeal dhe të trashëgimisë, Vendimi nr. 364, datë 29.05.2019, i Këshillit të Ministrave “Për Këshillin Kombëtar të Muzeve” përcakton rolin e Këshillit Kombëtar të Muzeve në vlerësimin dhe orientimin e projekteve muzeore me financim publik, ndërsa vendimi nr. 581, datë 28.08.2019, i Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore” rregullon funksionimin e Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat administrojnë dhe zbatojnë fonde për restaurimin dhe ndërhyrjet në pasuritë kulturore në nivel territorial.

Gjithashtu, vendimi nr. 434, datë 26.06.2019, i Këshillit të Ministrave Për funksionimin e Muzeut Kombëtar ‘Shtëpia me Gjethe” përcakton modelin e financimit dhe administrimit të Muzeut Kombëtar “Shtëpia me Gjethe”, duke reflektuar një qasje institucionale të bazuar në financim buxhetor dhe administrim të të ardhurave nga aktivitetet muzeore.

Sistemi mbështetet gjithashtu në legjislacionin për menaxhimin e financave publike dhe prokurimin publik, i cili garanton disiplinë fiskale, transparencë dhe eficiencë në përdorimin e fondeve publike. Megjithatë, ky kuadër rregullator është i projektuar për procedura standarde të shpenzimeve publike dhe nuk është i përshtatur për specifikat e tregut të artit dhe kulturës, i cili karakterizohet nga vlera unike të aseteve, mungesa e çmimeve të standardizuara dhe nevoja për vendimmarrje të shpejtë.

Në tërësi, kuadri rregullator ekzistues krijon një sistem të shpërndarë instrumentesh financimi kulturor, por pa një mekanizëm të unifikuar dhe të dedikuar për investime strategjike në art dhe për ndërtimin e koleksioneve publike. Kjo rezulton në një boshllëk institucional në aftësinë e shtetit për të vepruar si investitor aktiv në tregun e artit, duke justifikuar nevojën për krijimin e një fondi të specializuar, të integruar në sistemin buxhetor dhe të orientuar drejt zhvillimit afatgjatë të sektorit kulturor.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*

Në Shqipëri, sektori i artit dhe trashëgimisë kulturore karakterizohet nga mungesa e një instrumenti të posaçëm financiar dhe institucional që të mundësojë ndërhyrje strategjike, të koordinuar dhe fleksibël në zhvillimin e tregut të artit dhe në pasurimin e koleksioneve publike. Aktualisht, financimi i këtij sektori mbështetet kryesisht në alokime buxhetore vjetore për institucionet publike kulturore, të cilat janë të orientuara kryesisht drejt mbulimit të shpenzimeve operative (si paga, mirëmbajtja dhe funksionimi bazë), dhe jo drejt investimeve zhvillimore apo strategjike.

- *Identifikoni shkaqet e problemit.*

Shkaqet e problematikës në sektorin e artit dhe trashëgimisë kulturore lidhen kryesisht me mënyrën aktuale të organizimit institucional dhe financiar të financimit publik në këtë fushë.

Së pari, struktura buxhetore ekzistuese është e orientuar kryesisht drejt mbulimit të shpenzimeve fikse dhe operative të institucioneve publike kulturore, si paga, mirëmbajtja dhe funksionimi bazë. Ky konfigurim nuk parashikon linja të dedikuara investimi për blerje të veprave të artit apo për pasurimin sistematik të koleksioneve publike, duke kufizuar ndjeshëm kapacitetin zhvillimor të sektorit.

Së dyti, mungon një mekanizëm i centralizuar dhe i specializuar për vendimmarrje dhe financim në fushën e artit, i cili do të mundësonte koordinim ndërinstitutional dhe orientim strategjik të investimeve publike. Aktualisht, vendimmarrja shpërndahet ndërmjet disa institucioneve dhe strukturave ad hoc, çka sjell mungesë standardizimi, vonesa në proces dhe mungesë prioritetesh të qarta kombëtare.

Së treti, procedurat ekzistuese buxhetore dhe administrative janë të ngurta dhe nuk i përshtaten dinamikës së tregut të artit, i cili karakterizohet nga mundësi të kufizuara në kohë dhe nevojë për vendimmarrje të shpejtë. Kjo bën që institucionet publike të mos kenë akses të menjëhershëm në fonde në momentin kur paraqiten mundësi për blerje të veprave me vlerë të lartë artistike dhe historike.

Së katërti, mungon një qasje e integruar për përfshirjen e sektorit privat dhe mekanizmave alternativë të financimit kulturor në mënyrë strategjike dhe të koordinuar. Edhe pse ekzistojnë forma të donacioneve dhe sponsorizimeve, ato mbeten të fragmentuara dhe nuk kontribuojnë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm investimesh në kulturë.

Së fundi, mungesa e një politike të unifikuar afatgjatë për zhvillimin e koleksioneve publike dhe ndërhyrjen në tregun e artit ka sjellë një qasje reaktive dhe jo planifikuese, ku ndërhyrjet realizohen në mënyrë sporadike dhe jo mbi bazën e një strategjie të konsoliduar kombëtare.

- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*

Problematika e mungesës së një instrumenti të dedikuar financiar për artin dhe trashëgiminë kulturore ka shtrirje në të gjithë sistemin publik kulturor në Republikën e Shqipërisë, duke prekur si nivelin qendror të vendimmarrjes, ashtu edhe institucionet zbatuese në terren. Kjo problematikë nuk kufizohet në një institucion të vetëm, por është e shpërndarë në disa struktura të administratës shtetërore, përfshirë ministrinë përgjegjëse për kulturën, institucionet muzeale dhe galeritë kombëtare, si dhe njësitë e tjera publike që administrojnë pasuri kulturore.

Në nivel kombëtar, mungesa e një fondi të dedikuar për investime në art bën që ndërhyrjet shtetërore në tregun e artit të jenë sporadike dhe të pakoordinuara, duke mos ndjekur një strategji të unifikuar për pasurimin e koleksioneve publike. Kjo shtrirje kombëtare e problemit reflektohet në mungesën e blerjeve sistematike të veprave të artit dhe në pamundësinë për të ndërtuar koleksione publike të balancuara sipas periudhave, autorëve apo shkollave artistike.

Në nivel institucional, problemi shfaqet në fragmentimin e proceseve vendimmarrëse dhe financiare, ku kompetencat ndahen ndërmjet disa institucioneve pa një mekanizëm qendror koordinues. Kjo sjell vonesa administrative, mungesë standardizimi në vlerësim dhe vendimmarrje, si dhe mungesë kapaciteti për reagim të shpejtë në rastet e mundësive të kufizuara në kohë në tregun e artit, si ankandet apo ofertat private.

Në nivel tregu, shtrirja e problemit shfaqet në ndërveprimin e kufizuar ndërmjet shtetit dhe aktorëve privatë të artit, duke krijuar një treg të vogël, me likuiditet të ulët dhe me pak transaksione të mbështetura nga politika publike. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e ekosistemit artistik, duke kufizuar qarkullimin e veprave dhe investimet në këtë sektor.

Në tërësi, shtrirja e problemit është sistemike dhe prek njëkohësisht aspektin financiar, institucional dhe tregtar të sektorit të artit dhe kulturës, duke dëshmuar nevojën për një ndërhyrje të unifikuar dhe të qëndrueshme në nivel politikash publike.

- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*

Problematikat e identifikuar në kuadrin aktual ligjor dhe institucional lidhen drejtpërdrejt me mënyrën e strukturimit të financimit publik në fushën e artit dhe kulturës, i cili është i orientuar kryesisht drejt mbulimit të shpenzimeve operative dhe i karakterizuar nga mungesa e një mekanizmi të dedikuar për investime strategjike dhe ndërhyrje fleksibile në tregun e artit. Kjo strukturë krijon një zinxhir kufizimesh funksionale që reflektohen në mënyrë të ndryshme tek grupet kryesore të prekura.

Institucionet publike kulturore (muze, galeri dhe institucione të ngjashme) preken drejtpërdrejt nga fakti që financimi i tyre është i paracaktuar dhe i ngurtë në zëra operativë, duke mos parashikuar linja të posaçme për investime në koleksione apo blerje strategjike. Për rrjedhojë, këto institucione nuk kanë fleksibilitet financiar për të rialokuar fonde në raste emergjente apo mundësish të favorshme në treg, si ankandet ndërkombëtare ose ofertat e kufizuara në kohë. Gjithashtu, procedurat e gjata të miratimit buxhetor dhe mungesa e disponueshmërisë së menjëhershme të fondeve bëjnë që institucionet shpesh të mos marrin pjesë në këto procese, duke sjellë humbjen e veprave me vlerë kombëtare dhe zhvillim të ngadaltë të koleksioneve publike.

Komuniteti artistik ndikohet nga mungesa e një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të koordinuar mbështetës, e cila lidhet me fragmentimin e vendimmarrjes dhe mungesën e një strukture të centralizuar që orienton

investimet në art. Si pasojë, mbështetja publike për krijimtarinë artistike karakterizohet nga mungesa e parashikueshmërisë dhe shpesh është e kufizuar në thirrje ose projekte afatshkurtra. Kjo ul kapacitetin e artistëve për planifikim afatgjatë, kufizon ekspozimin e veprave të tyre dhe redukton mundësitë për integrim më aktiv në tregun e artit dhe në jetën kulturore.

Sektori privat dhe tregu i artit preken nga mungesa e një mekanizmi të unifikuar institucional për ndërveprim me shtetin në fushën e blerjeve dhe investimeve kulturore. Në mungesë të një strukture të specializuar dhe të një politike të qartë blerjesh publike, tregu mbetet i fragmentuar dhe me likuiditet të ulët. Kjo situatë përforcohet nga procedurat administrative të ngurta dhe jo të përshtatura me dinamikën e tregut të artit, duke kufizuar transaksionet dhe duke reduktuar potencialin për zhvillim të një mjedisi më konkurrues dhe bashkëpunues ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë.

Publiku i gjerë, si përfituesi përfundimtar i politikave kulturore, ndikohet në mënyrë të tërthortë nga këto kufizime strukturore, pasi mungesa e investimeve strategjike dhe e një mekanizmi të qëndrueshëm për pasurimin e koleksioneve publike kufizon numrin dhe cilësinë e veprave të ekspozuara. Si rrjedhojë, zvogëlohet mundësia e qytetarëve për akses të gjerë dhe të vazhdueshëm në art dhe kulturë, duke kufizuar ndikimin edukativ, social dhe kulturor që këto vlera prodhojnë në shoqëri.

- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave*

Problemi nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes instrumenteve ekzistuese buxhetore dhe administrative, pasi këto nuk garantojnë fleksibilitet të mjaftueshëm, shpejtësi në vendimmarrje dhe orientim investues. Për rrjedhojë, ndërhyrja përmes krijimit të një mekanizmi të dedikuar financiar dhe institucional vlerësohet si e domosdoshme për të mundësuar koordinim të unifikuar institucional, rritje të kapacitetit për ndërhyrje në tregun e artit dhe forcim të investimeve publike në fushën e artit dhe kulturës.

Arsyeja e ndërhyrjes

Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.

Zhvillimi i sektorit të artit dhe kulturës në Shqipëri është kufizuar nga mungesa e një instrumenti të dedikuar financiar dhe institucional që mund të mundësojë ndërhyrje strategjike në tregun e artit dhe pasurimin sistematik të koleksioneve publike. Financimi aktual bazohet kryesisht në alokime buxhetore vjetore për institucionet publike kulturore, të paracaktuara për shpenzime operative si paga, mirëmbajtje dhe funksionim bazë.

Kjo mënyrë financimi krijon një kufizim strukturor, pasi fondet nuk parashikojnë hapësira për investime zhvillimore, si blerja e veprave të artit, zgjerimi i koleksioneve publike apo ndërhyrje në tregun e artit. Institucionet duhet të kalojnë përmes procedurave të gjata të miratimit buxhetor për çdo blerje, gjë që nuk përputhet me dinamikën e tregut të artit, ku vendimmarrja duhet të jetë e shpejtë.

Fragmentimi institucional, ku përgjegjësitë shpërndahen ndërmjet ministrisë përgjegjëse, institucioneve të varura dhe komisioneve *ad hoc*, nuk garanton një prioritetizim të unifikuar të investimeve dhe pengon vendimmarrjen e shpejtë dhe të bazuar në ekspertizë.

- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

Ndërhyrja e qeverisë synon të adresojë kufizimet strukturore dhe institucionale që pengojnë zhvillimin strategjik të sektorit të artit dhe kulturës. Kjo përfshin:

- a) krijimin e hapësirave financiare për investime strategjike, duke përfshirë blerjen e veprave të artit dhe zgjerimin e koleksioneve publike;
- b) rritjen e fleksibilitetit të vendimmarrjes për të reaguar ndaj mundësive të tregut dhe ankandeve ndërkombëtare;
- c) unifikimin dhe koordinimin institucional për të pasur një strategji të qartë kombëtare për zhvillimin e artit;
- d) zhvillimin e një mekanizmi të qëndrueshëm për të mobilizuar dhe orientuar mbështetjen e sektorit privat drejt objektivave publike.

Këto ndërhyrje synojnë të rrisin kapacitetin e institucioneve publike dhe të komunitetit artistik për planifikim afatgjatë dhe pjesëmarrje aktive në tregun e artit.

- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

Ndërhyrja mbështet objektivat strategjike të qeverisë për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore, për promovimin e artit dhe kulturës, si pjesë e identitetit kombëtar, si dhe për rritjen e aksesit të publikut në vlera kulturore.

- a) Sigurimi i fondeve dhe fleksibiliteti vendimmarrës kontribuon në zhvillimin e koleksioneve publike dhe ruajtjen e veprave me vlerë kombëtare;
 - b) Koordinimi institucional dhe politika e qartë e investimeve kulturore përforcon një qasje strategjike, që lidhet me objektivat e qeverisë për zhvillim të qëndrueshëm kulturor;
 - c) Lidhja me sektorin privat dhe mekanizmat e mbështetjes alternative promovon një mjedis kulturor të qëndrueshëm dhe të hapur ndaj inovacionit.
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Aktualisht, sektori i artit dhe kulturës financohet kryesisht përmes alokimeve buxhetore vjetore që mbulojnë shpenzime operative. Ligji parashikon mundësi për sponsorizime dhe donacione, por këto mekanizma mbeten të fragmentuara dhe të varura nga iniciativa individuale.

Institucionet publike operojnë brenda një kuadri procedural që nuk lejon ndërhyrje të shpejta ose fleksibël në tregun e artit. Gjithashtu, nuk ekziston një strukturë e vetme e specializuar për vendimmarrje strategjike, gjë që rezulton në fragmentim institucional dhe mungesë të prioritetizimit të investimeve.

Këto kufizime kanë rezultuar në mbështetje të pamjaftueshme për krijimtarinë artistike, humbje mundësish për sigurimin e veprave me rëndësi kombëtare dhe reduktim të aksesit publik në jetën kulturore.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi i përgjithshëm i kësaj politike është krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm, eficient dhe transparent për financimin dhe zhvillimin e sektorit të artit dhe kulturës, përmes ngritjes dhe funksionalizimit të Fondit Kombëtar për Artin, i cili do të mundësojë mbështetje afatgjatë për krijimtarinë artistike, pasurimin e koleksioneve publike dhe rritjen e aksesit të publikut në kulturë.

Në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm, përcaktohen këto objektiva specifike, të matshëm dhe të realizueshëm:

1. Krijimi dhe funksionalizimi i Fondit Kombëtar për Artin brenda vitit 2027, përmes integritit të tij në sistemin e menaxhimit të financave publike
2. Ngritja dhe funksionalizimi i strukturave zbatuese të fondit, përfshirë Komisionin e blerjes së veprave të artit dhe Sekretariatit Teknik, duke garantuar kapacitete profesionale, procedura të qarta vendimmarrjeje dhe funksionim efektiv në përputhje me kërkesat ligjore.
3. Sigurimi i një burimi të qëndrueshëm financimi, duke alokuar çdo vit 10% të kursimeve nga prokurimet publike në Fond, me qëllim garantimin e vazhdimësisë dhe parashikueshmërisë së financimit.
4. Rritja e eficiencës në përdorimin e fondeve publike, përmes përdorimit të një mekanizmi të dedikuar dhe të kontrolluar, që synon maksimizimin e ndikimit kulturor të investimeve brenda vitit 2028.
5. Rritja e numrit të veprave të regjistruara në inventarin publik me të paktën 20%, me synim arritjen deri në 30% brenda vitit 2029.
6. Përmirësimi i aksesit të publikut në art dhe kulturë, përmes ekspozimit të veprave të blera në institucione publike dhe hapësira të aksesueshme, duke synuar rritjen me të paktën 15% të pjesëmarrjes së publikut në aktivitete kulturore deri në vitin 2029.
7. Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies, përmes publikimit vjetor të raporteve financiare, listës së veprave të blera dhe rezultateve të financimit, si dhe sigurimit të auditimit periodik nga organet kompetente.
8. Nxitja e bashkëpunimit me sektorin privat, duke rritur gradualisht kontributin e donacioneve dhe sponsorizimeve në fond, me synim që ato të përbëjnë të paktën 10% të totalit të financimit të fondit brenda vitit 2031.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 0: Status quo (vijimi i gjendjes aktuale pa ndërhyrje ligjore apo institucionale). Ky opsion nënkupton vijimin e gjendjes aktuale, pa ndërhyrje ligjore apo institucionale në mënyrën e financimit dhe menaxhimit të sektorit të artit dhe kulturës. Financimi do të vazhdojë të realizohet përmes buxhetit vjetor të shtetit dhe skemave ekzistuese të mbështetjes publike, pa krijimin e instrumenteve të reja financiare apo strukturore.

Ky model nuk adreson kufizimet strukturore të sistemit ekzistues, të cilat lidhen me mungesën e fleksibilitetit financiar, mungesën e fondeve të dedikuara për investime strategjike dhe mungesën e kapacitetit për ndërhyrje të shpejtë në tregun e artit. Si rezultat, sistemi mbetet i orientuar kryesisht drejt shpenzimeve operative dhe jo drejt investimeve zhvillimore.

Në këto kushte, vijon rreziku i humbjes së mundësive për blerjen dhe ruajtjen e veprave me vlerë kombëtare, si dhe mungesa e një qasjeje afatgjatë dhe të strukturuar për zhvillimin e koleksioneve publike dhe tregut të artit.

Opsioni 1: (jorregullator) (rritje e financimit brenda kuadrit ekzistues).

Ky opsion parashikon rritjen e alokimeve buxhetore për sektorin e artit dhe kulturës, pa ndryshuar strukturën institucionale apo mekanizmat ekzistues të financimit. Mbështetja financiare do të vijojë të realizohet përmes skemave aktuale buxhetore dhe thirrjeve për projekte.

Megjithëse ky opsion sjell rritje sasiore të financimit, ai nuk adreson kufizimet strukturore të sistemit. Fondet vazhdojnë të jenë kryesisht të orientuara drejt shpenzimeve operative dhe jo investimeve strategjike, duke kufizuar hapësirën për blerje veprash arti apo ndërhyrje aktive në treg.

Gjithashtu, ky opsion nuk krijon mekanizma të specializuar vendimmarrjeje, nuk rrit fleksibilitetin në përdorimin e fondeve dhe nuk mundëson reagim të shpejtë në rastet e mundësive në tregun e artit, si ankandet ose ofertat e kufizuara në kohë. Për rrjedhojë, ndryshimi mbetet kryesisht sasior dhe jo cilësor në funksionimin e sistemit.

Opsioni 2: (opsioni i preferuar) (krijimi i Fondit Kombëtar për Artin)

Ky opsion parashikon krijimin e një fondi të dedikuar publik për artin dhe kulturën, të integruar në sistemin e financave publike dhe të financuar nga 10% e kursimeve të realizuara nga prokurimet publike, duke respektuar parimin e neutralitetit fiskal dhe pa krijuar kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Fondi funksionon si një mekanizëm i specializuar për financimin e investimeve në art dhe kulturë, i mbështetur nga një strukturë vendimmarrëse kolegjiale (Komision ekspertësh) dhe një sekretariat teknik. Ky konfigurim siguron profesionalizëm, transparencë dhe ndarje të qartë të funksioneve institucionale.

Ky opsion mundëson fleksibilitet të lartë në ndërhyrje në tregun e artit, përfshirë blerje në ankande ndërkombëtare ose transaksione të drejtpërdrejta, si dhe garanton reagim të shpejtë në raste mundësish të kufizuara në kohë. Gjithashtu, krijon një bazë të qëndrueshme financimi dhe mundëson planifikim afatgjatë të investimeve.

Në aspektin institucional, ky opsion adreson fragmentimin ekzistues duke centralizuar vendimmarrjen për investimet strategjike në art dhe duke forcuar mekanizmat e transparencës, raportimit dhe auditimit publik. Në këtë mënyrë, sistemi kalon nga një qasje e shpërndarë dhe reaktive në një model të strukturuar dhe strategjik të investimeve kulturore.

Opsioni 3: (skemë PPP dhe financim hibrid)

Ky opsion konsiston në mbështetjen e sektorit të artit dhe kulturës përmes një modeli bashkëpunimi ndërmjet shtetit, sektorit privat dhe donatorëve, pa krijimin e një fondi të dedikuar të integruar në sistemin buxhetor. Financimi realizohet përmes sponsorizimeve, donacioneve dhe partneriteteve publike-private.

Ky model rrit potencialisht burimet financiare të sektorit dhe nxit përfshirjen e aktorëve privatë në zhvillimin kulturor, duke rritur diversitetin e projekteve të mbështetura dhe fleksibilitetin e financimit.

Megjithatë, ky opsion nuk garanton qëndrueshmëri financiare afatgjatë, pasi varet nga vullneti dhe interesat e sektorit privat dhe donatorëve. Mungesa e një mekanizmi të centralizuar rrit rrezikun e fragmentimit të financimit dhe mungesës së koherencës në politikat kulturore. Për rrjedhojë, ky opsion nuk siguron nivelin e stabilitetit dhe parashikueshmërisë që kërkohet për zhvillim strategjik të sektorit të artit dhe kulturës.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Zbatimi i opsioneve të analizuara prek disa grupe kryesore të interesit, përkatësisht: institucionet publike kulturore, komunitetin artistik, sektorin privat të artit dhe industrisë kreative, publikun e gjerë si përfitues përfundimtar, si dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për administrimin financiar dhe kulturor. Përveç këtyre, ndikohen edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që operojnë në fushën e shërbimeve kulturore, artistike dhe kreative, konkretisht:

Grupet e prekura

Zbatimi i opsioneve të analizuara prek disa grupe kryesore të interesit:

1. Institucionet publike kulturore (muze, galeri, teatro).
2. Artistët dhe komuniteti krijues.
3. Ministria përgjegjëse për kulturën dhe strukturat zbatuese (Komisioni dhe Sekretariati Teknik).
4. Institucionet e financave publike dhe prokurimit.
5. Sektori privat (galeri, donatorë, sponsorë, tregu i artit).
6. Publiku i gjerë.
7. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në sektorin kulturor dhe kreativ.

Ndikimet e drejtpërdrejta

2. Artistët dhe komuniteti krijues

Për komunitetin artistik, ndikimi i drejtpërdrejtë reflektohet në rritjen e kërkesës institucionale për vepra arti, duke krijuar një kanal të ri shitjeje dhe duke rritur stabilitetin e të ardhurave. Ky mekanizëm sjell më shumë mundësi për ekspozim dhe pjesëmarrje aktive në tregun e artit.

3. Ministria dhe strukturat zbatuese

Këto institucione marrin një funksion të ri organizativ dhe administrativ për menaxhimin e fondeve të dedikuara. Ndikimi përfshin rritjen e përgjegjësive, nevojën për kapacitete të specializuara dhe përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes, përmes procedurave të qarta dhe funksionimit profesional.

4. Institucionet e financave publike dhe prokurimit

Për këto institucione, ndikimi lidhet me identifikimin dhe transferimin e kursimeve të krijuara nga prokurimet publike drejt fondit. Në aspektin praktik, lind nevoja për parashikimin e procedurave të reja të koordinimit dhe monitorimit.

Megjithatë, kjo ndërhyrje forcon lidhjen midis eficiencës fiskale dhe politikave sektoriale, duke e kthyer kursimin buxhetor në një burim të ri investimi zhvillimor.

5. Sektori privat dhe tregu i artit

Ndikimi është kryesisht i tërthortë, por strategjik. Prania e një blerësi publik të qëndrueshëm rrit besimin në treg, nxit bashkëpunimin publik-privat dhe rrit interesin për sponsorizime dhe donacione.

6. Publiku i gjerë

Ndikimi është i tërthortë dhe përqendrohet në përmirësimin e aksesit në art dhe kulturë. Rritja e koleksioneve publike dhe ekspozimeve përmirëson edukimin kulturor, identitetin kulturor dhe kohezionin social, pa kosto të drejtpërdrejtë për qytetarët.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Ndikimet jo të drejtpërdrejta të opsioneve të analizuara shtrihen përtej institucioneve dhe aktorëve të drejtpërdrejtë të përfshirë në financimin e artit, duke ndikuar në mënyrë më të gjerë në zhvillimin social, ekonomik dhe institucional të sektorit kulturor.

Në aspektin social, krijimi i Fondit Kombëtar për Artin ka efekt më të dukshëm pozitiv, pasi rrit në mënyrë të qëndrueshme aksesin e publikut në art dhe kulturë. Përmes pasurimit të koleksioneve publike dhe shtimit të ekspozimeve në institucione kulturore, përmirësohet ekspozimi i qytetarëve ndaj artit, çka ndikon në edukimin kulturor, forcimin e kohezionit social dhe konsolidimin e identitetit kulturor. Në krahasim, opsionet e tjera nuk krijojnë një mekanizëm të dedikuar që të garantojë rritje sistematike të këtij aksesit, ndaj ndikimi i tyre mbetet më i kufizuar dhe më pak i qëndrueshëm.

Në aspektin ekonomik, fondi prodhon efekte indirekte pozitive në zhvillimin e ekonomisë kreative dhe të turizmit kulturor. Rritja e investimeve publike në art sjell më shumë ekspozita, aktivitete kulturore dhe ngjarje artistike, të cilat nga ana e tyre gjenerojnë kërkesë për shërbime të lidhura si organizimi i eventeve,

shërbimet muzeale, marketingu kulturor dhe turizmi. Kjo krijon një efekt zinxhir që shkon përtej sektorit kulturor në kuptimin e ngushtë dhe ndikon në ekonominë lokale dhe kombëtare.

Në aspektin e konkurrencës, krijimi i fondit pritet të formalizojë më tej tregun e artit dhe të rrisë standardet profesionale të funksionimit të tij. Prania e një blerësi institucional të qëndrueshëm dhe transparent rrit konkurrencën midis aktorëve të tregut, duke nxitur cilësi më të lartë dhe profesionalizim të ofertës artistike. Megjithatë, ekziston edhe një rrezik potencial i përqendrimit të kërkesës publike tek një numër i kufizuar galerish, artistësh ose ndërmjetësish të tregut, veçanërisht në fazat e para të zbatimit të politikës. Për këtë arsye, bëhet e nevojshme vendosja e mekanizmave të qartë transparence, konkurrimi dhe barazie në akses, në mënyrë që të shmanget deformimi i tregut.

Kufizimi i analizës

Analiza e ndikimeve dhe përlllogaritjeve bazohet në disa supozime kryesore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e rezultateve të parashikuara. Në mënyrë të veçantë, ajo mbështetet në:

- a) stabilitetin e kursimeve të gjeneruara nga procedurat e prokurimit publik në kohë;
- b) funksionimin efektiv dhe të pandërprerë të mekanizmave institucionalë të propozuar;
- c) ekzistencën dhe zhvillimin e një tregu të mjaftueshëm të artit që mund të përballojë kërkesën e krijuar nga ndërhyrja publike.

Rreziqet kryesore përfshijnë:

- a) ndryshime në nivelin e eficiencës dhe performancës së sistemit të prokurimeve publike, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në masën e kursimeve të gjeneruara;
- b) vonesa në miratimin dhe zbatimin e akteve nënligjore, të cilat janë të domosdoshme për funksionalizimin e plotë të fondit dhe strukturave të tij;
- c) kapacitete të kufizuara institucionale dhe mungesë të ekspertizës së specializuar për vlerësimin dhe përzgjedhjen e veprave të artit;
- ç) rrezik i mungesës së efikasitetit në proceset e përzgjedhjes dhe blerjes së veprave të artit, veçanërisht në fazat fillestare.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

a) Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.

b) Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i preferuar, i identifikuar përmes analizës me shumë kritere, është **Opsioni 2: krijimi i Fondit Kombëtar për Artin.**

Ky opsion është vlerësuar me pikëzimin më të lartë krahasuar me alternativat e tjera dhe për rrjedhojë është përzgjedhur si zgjidhja më e përshtatshme për adresimin e problematikave të identifikuara në sektorin e artit dhe kulturës.

Krijimi i fondit siguron një burim të qëndrueshëm financimi përmes rialokimit të 10% të kursimeve nga prokurimet publike, pa krijuar kosto të reja për buxhetin e shtetit. Ky mekanizëm rrit eficiencën e shpenzimeve publike dhe u mundëson institucioneve kulturore të kryejnë blerje strategjike dhe investime zhvillimore në art.

Fondit i shoqërohet një strukturë e specializuar vendimmarrëse dhe zbatuese, e përbërë nga Komisioni i ekspertëve dhe Sekretariati Teknik, që rrit transparencën, profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë në administrimin e fondeve. Kjo lejon planifikim afatgjatë, qasje strategjike dhe përmirësim të qeverisjes së politikave kulturore.

Në përmbledhje, opsioni ofron një zgjidhje të integruar dhe të balancuar, duke kaluar nga një model fragmentar dhe reaktiv drejt një modeli të strukturuar dhe të orientuar drejt rezultateve.

Risitë e projektligjit:

Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar për Artin” parashikon një sërë elementesh të reja institucionale dhe financiare:

1. **Burimi i financimit:** Fondi mbushet me 10% të kursimeve të gjeneruara nga prokurimet publike, duke kthyer eficiencën buxhetore në investime zhvillimore, pa kosto shtesë për buxhetin e shtetit.
2. **Struktura vendimmarrëse:** Komisioni i ekspertëve (3–7 anëtarë) merr vendimet për përzgjedhjen e veprave artistike, ndërsa sekretariati teknik ofron mbështetje administrative dhe zbatimin operacional.
3. **Fleksibilitet në blerje:** Procedurat e blerjes së veprave përfshijnë ankande publike dhe marrëveshje të drejtpërdrejta, duke mundësuar reagim të shpejtë dhe konkurrues në treg.
4. **Formalizimi i pronësisë:** Të gjitha veprat regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore dhe rritet aksesueshmëria e publikut përmes ekspozimeve.
5. **Transparenca dhe llogaridhënia:** Parashikohet raportim vjetor, auditim financiar dhe mekanizma për parandalimin e konflikteve të interesit, për të garantuar besueshmëri dhe integritet institucional.

Në tërësi, Fondi Kombëtar për Artin konceptohet si një instrument strategjik i politikës publike, i orientuar drejt qëndrueshmërisë, integritetit dhe rezultateve konkrete në zhvillimin kulturor dhe social.

Bazuar në analizën me shumë kritere, **Opsioni 2 – Krijimi i Fondit Kombëtar për Artin** është identifikuar si opsioni më i përshtatshëm dhe është përzgjedhur si opsioni i preferuar për implementimin e politikës publike.

Për vlerësimin e alternativave janë marrë në konsideratë katër opsione:

- **Opsioni 0** – Ruajtja e status quo-së;
- **Opsioni 1** – Rritja e financimit përmes buxhetit ekzistues;
- **Opsioni 2** – Krijimi i Fondit Kombëtar për Artin;
- **Opsioni 3** – PPP (Partneritet Publik-Privat) për financimin dhe zhvillimin e ndërhyrjeve në art dhe kulturë.

Metodologjia e analizës

Është aplikuar një analizë me shumë kritere, e cila synon të krahasojë opsionet në mënyrë të balancuar duke marrë parasysh dimensionet fiskale, institucionale, ekonomike dhe sociale të politikës.

Janë përcaktuar këto kritere:

1. Neutraliteti fiskal dhe ndikimi në buxhetin e shtetit;
2. Eficienca në përdorimin e fondeve publike;
3. Efikasiteti në zhvillimin e sektorit të artit dhe kulturës;
4. Koherenca dhe konsolidimi institucional dhe rregullator;

5. Ndikimi në rritjen e aksesit të publikut në art dhe kulturë;
6. Kosto-efektiviteti i ndërhyrjes.

Pesha e kritereve

Peshat janë vendosur në bazë të rëndësisë së tyre relative:

- Neutraliteti fiskal dhe ndikimi në buxhet – 4
- Eficienca në përdorimin e fondeve publike – 4
- Efikasiteti në zhvillimin e sektorit – 4
- Koherenca institucionale dhe rregullatore – 4
- Aksesit i publikut në art dhe kulturë – 3
- Kosto-efektiviteti – 5

Vlerësimi i opsioneve (përmbledhje cilësore)

Opsionet janë vlerësuar në shkallë nga 0–5 për secilin kriter, të ponderuara sipas peshës përkatëse.

Opsioni 0 – Status quo

Ky opsion karakterizohet nga performancë e ulët në të gjitha kriteret e vlerësimit, veçanërisht në zhvillimin e sektorit dhe koherencën institucionale, pasi nuk adreson problematikat strukturore ekzistuese të financimit dhe menaxhimit të artit dhe kulturës. Si rrjedhojë, sistemi mbetet i fragmentuar dhe i orientuar kryesisht drejt mbulimit të shpenzimeve operative, pa krijuar hapësira për investime strategjike.

Opsioni 1 – Rritje e buxhetit ekzistues

Ky opsion sjell përmirësim të pjesshëm të nivelit të financimit për sektorin e artit dhe kulturës, por mbetet i kufizuar nga struktura ekzistuese buxhetore dhe institucionale. Ai nuk adreson problemet strukturore të sistemit dhe nuk sjell transformim të modelit të menaxhimit apo rritje të ndjeshme të eficiencës në përdorimin e fondeve publike.

Opsioni 3 – PPP (Partneritet Publik-Privat)

Ky opsion ofron potencial për tërheqjen e kapitalit privat dhe rritjen e investimeve në sektorin e artit dhe kulturës, duke krijuar mundësi shtesë financimi për projekte kulturore.

Megjithatë, mbart disa kufizime të rëndësishme strukturore:

- a) varet nga interesi i sektorit privat dhe kthimi ekonomik i projekteve kulturore;
- b) nuk garanton mbulim të plotë të nevojave për vepra me interes publik të lartë, por me kthim të ulët ekonomik;
- c) kërkon kapacitete të avancuara kontraktuale, rregullatore dhe menaxhuese për të shmangur rreziqet e performancës dhe devijimin e interesit publik.

Si rrjedhojë, PPP ofron fleksibilitet financiar, por nuk siguron në mënyrë të qëndrueshme përmbushjen e objektivit kryesor të politikës publike, që është ruajtja dhe zhvillimi i interesit kulturor kombëtar në mënyrë të barabartë dhe afatgjatë.

Opsioni 2 – Fondi Kombëtar për Artin

Ky opsion rezulton më i balancuari dhe më i përshtatshmi, pasi kombinon disa elemente kyçe të rëndësishme për zhvillimin e sektorit:

- a) stabilitet fiskal, pa rritje të drejtpërdrejtë të shpenzimeve buxhetore;
- b) krijimin e një mekanizmi të dedikuar dhe të qëndrueshëm financimi;
- c) vendimmarrje profesionale dhe të centralizuar;
- ç) kapacitet për ndërhyrje strategjike në tregun e artit;
- d) ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë të sektorit të artit dhe kulturës.

Ky opsion adreson në mënyrë strukturore boshllëqet e sistemit aktual dhe krijon bazën për një model më të qëndrueshëm, efikas dhe të orientuar drejt rezultateve në financimin e kulturës.

Matrica e performancës:

| Kriteret | Pesha (1–5) | Opsion i 0 | Pikët | Opsion i 1 | Pikët | Opsion i 2 | Pikët | Opsion i 3 | Pikët |
|---|-------------|------------|-----------|------------|-----------|------------|-----------|------------|-----------|
| Ndikimi social dhe rritja e aksesit të publikut në art dhe kulturë | 4 | 1 | 4 | 2 | 8 | 3 | 12 | 3 | 12 |
| Shkalla e koherencës, qartësisë dhe konsolidimit të kuadrit rregullator | 4 | 1 | 4 | 2 | 8 | 3 | 12 | 3 | 12 |
| Ndikimi në zhvillimin e sektorit të artit dhe kulturës | 5 | 1 | 5 | 3 | 15 | 4 | 20 | 4 | 20 |
| Eficienca në përdorimin e fondeve publike | 5 | 1 | 5 | 2 | 10 | 4 | 15 | 2 | 10 |
| Transparenca dhe llogaridhënia në administrimin e fondeve | 4 | 1 | 4 | 3 | 12 | 4 | 16 | 3 | 12 |
| Fleksibiliteti institucional dhe kapaciteti zbatues | 3 | 1 | 3 | 2 | 6 | 3 | 9 | 3 | 9 |
| Kosto – efektiviteti | 3 | 2 | 6 | 2 | 6 | 2 | 6 | 3 | 9 |
| Pikët totale për secilin opsion | | | 31 | | 65 | | 90 | | 84 |

Analiza me shumë kritere tregon qartë se **Opsioni 2: Krijimi i Fondit Kombëtar për Artin** është alternativa më e favorshme, duke arritur rezultatin më të lartë total me **90 pikë**.

Ky opsion performon më mirë se alternativat e tjera në pothuajse të gjitha dimensionet kryesore të vlerësimit, veçanërisht në:

- a) zhvillimin e sektorit të artit dhe kulturës,
- b) eficiencën në përdorimin e fondeve publike,
- c) koherencën dhe konsolidimin institucional,
- ç) transparencën dhe llogaridhënien.

Në krahasim, Opsioni 3 (PPP) ofron performancë të mirë në aspektin e zhvillimit dhe fleksibilitetit financiar, por mbetet më i kufizuar në garantimin e interesit publik afatgjatë dhe koherencës institucionale, ndërsa Opsioni 1 dhe *status quo* rezultojnë dukshëm më pak efektive.

- **Çështje të zbatimit**

Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Zbatimi i opsionit të zgjedhur, pra krijimi dhe funksionimi i Fondit Kombëtar për Artin, realizohet brenda kuadrit ekzistues institucional dhe buxhetor të shtetit, pa krijimin e një institucioni të ri të posaçëm.

Fondi konceptohet si një fond special publik brenda Buxhetit të Shtetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Ministria përgjegjëse për kulturën është autoriteti kryesor përgjegjës për drejtimin, administrimin dhe orientimin strategjik të fondit. Në këtë proces, ministria përgjegjëse për financat luan rol mbështetës në garantimin e transferimit, konsolidimit dhe raportimit të fondeve, në përputhje me rregullat e menaxhimit të financave publike.

Zbatimi operacional mbështetet nga:

- 1) një Komision i posaçëm për blerjen e veprave të artit, i përbërë nga ekspertë të fushës;
- 2) një sekretariat teknik, i cili siguron mbështetjen administrative, dokumentacionin dhe koordinimin ndërinstitutional.

Ky model garanton ndarje të qartë midis vendimmarrjes profesionale dhe zbatimit teknik, pa krijuar struktura të përhershme shtesë.

Gjatë zbatimit mund të shfaqen disa sfida kryesore, përfshirë:

- a) nevoja për koordinim të lartë ndërinstitutional midis kulturës dhe financave publike;
- b) kapacitete të kufizuara teknike në fazat e para të implementimit;
- c) vonesa të mundshme në miratimin e akteve nënligjore dhe procedurave zbatuese;
- ç) vështirësi në identifikimin dhe vlerësimin profesional të veprave të artit në treg;
- d) rreziku i moszhvillimit të mjaftueshëm të tregut vendas të artit për të përmbushur kërkesën institucionale.

Masat për sigurimin e zbatimit efektiv

Për të garantuar funksionimin efektiv të fondit dhe arritjen e objektivave të politikës, parashikohen këto masa:

1. Monitorim dhe raportim periodik

Do të realizohet raportim vjetor mbi përdorimin e fondit, realizimin e objektivave dhe ndikimin e investimeve në sektorin e artit dhe kulturës.

2. Vlerësim i performances

Ministria përgjegjëse për kulturën, në bashkëpunim me ministrinë e financave, do të kryejë vlerësime periodike mbi eficiencën dhe ndikimin e fondit.

4. Forcimi i kapaciteteve institucionale

Do të organizohen trajnime për strukturat zbatuese dhe ekspertët me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe standardizimin e praktikave.

5. Kontroll financiar dhe auditim

Fondi do t'i nënshtrohet kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit nga institucionet përgjegjëse, për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie.

6. Gjurmueshmëria e veprave të përfituara

Do të krijohen mekanizma për inventarizimin, regjistrimin dhe ndjekjen e veprave të blera, duke siguruar administrim të rregullt dhe ruajtje të tyre.

7. Transparencë publike

Do të publikohen periodikisht raportet mbi përdorimin e fondit, vendimmarrjet dhe rezultatet e arritura.

8. Rishikim i kuadrit rregullator

Në rast të evidentimit të problematikave gjatë zbatimit, do të ndërmerren përditësime të akteve nënligjore dhe procedurave administrative.

9. Bashkëpunim ndërinstytucional i vazhdueshëm

Do të sigurohet koordinim i rregullt ndërmjet institucioneve përgjegjëse për kulturën, financat dhe strukturave zbatuese.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

Faza e monitorimit dhe vlerësimit përbën një element thelbësor për të siguruar zbatimin efektiv të Fondit Kombëtar për Artin dhe arritjen e objektivave të përcaktuara. Kjo fazë mbështetet në një proces të vazhdueshëm ndjekjeje, raportimi dhe vlerësimi të performancës së fondit, duke përfshirë aspektin financiar, institucional dhe kulturor.

Monitorimi

Monitorimi do të realizohet nga Ministria përgjegjëse për kulturën, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe institucionet përfituese. Ky proces përfshin mbledhjen dhe analizimin periodik të të dhënave mbi përdorimin e fondeve, numrin dhe vlerën e veprave të përfituara, si dhe mënyrën e ekspozimit dhe shpërndarjes së tyre.

Një komponent i rëndësishëm i monitorimit është publikimi i raportit vjetor të aktivitetit të fondit, i cili garanton transparencë dhe informim të plotë për institucionet mbikëqyrëse dhe publikun.

Vlerësimi

Vlerësimi do të kryhet në mënyrë periodike me qëllim analizimin e shkallës së arritjes së objektivave dhe identifikimin e nevojave për përmirësim në zbatim. Ky proces përfshin vlerësim të brendshëm institucional, si dhe auditim të jashtëm financiar dhe të performancës nga organet kompetente të kontrollit publik.

Në këtë mënyrë sigurohet një vlerësim i plotë i efektivitetit, eficiencës dhe ndikimit të politikës.

Treguesit e monitorimit

Për matjen e progresit dhe arritjes së objektivave do të përdoren këta tregues kryesorë:

- a) niveli vjetor i fondeve të gjeneruara nga kursimet e prokurimeve publike;
- b) përqindja e përdorimit të fondeve në raport me fondet e disponueshme;
- c) numri i veprave të reja të regjistruara në inventarin publik;
- ç) rritja e koleksioneve të institucioneve publike kulturore;
- d) numri i institucioneve përfituese nga fondi;
- dh) numri i ekspozimeve dhe aktiviteteve kulturore të financuara;
- e) niveli i pjesëmarrjes së publikut në aktivitete kulturore;
- ë) niveli i transparencës përmes publikimit të raporteve dhe vendimeve;
- f) shkalla e përfshirjes së sektorit privat përmes donacioneve dhe sponsorizimeve;
- g) rezultatet e auditimeve dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor.

Qasje në mungesë të të dhënave fikse

Duke qenë se financimi i fondit lidhet me kursimet nga prokurimet publike, të cilat janë variabël, nuk është gjithmonë e mundur të përcaktohen tregues sasiore me vlera fikse paraprakisht.

Për këtë arsye, monitorimi do të fokusohet edhe në analizën e tendencave në kohë, krahasimin ndërvjetor të treguesve dhe vlerësimin cilësor të ndikimit, veçanërisht për sa i përket vlerës artistike dhe kulturore të veprave të financuara.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

| | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Viti 6 | Viti 7 | Viti 8 | Viti 9 | Viti 10 |
|--|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|---------|
| Faktori zbritës (5%) | 0.952 | 0.907 | 0.864 | 0.864 | 0.864 | 0.864 | 0.864 | 0.864 | 0.864 | 0.864 |
| Kosto për buxhetin - një herë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kosto për buxhetin - në vazhdimësi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kosto për bizneset - një herë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kosto për bizneset - në vazhdimësi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kosto për grupet e tjera - një herë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kosto në total | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Përfitimet për buxhetin – një herë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | | |
|--|------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Përfitimet për tregu i artit dhe sektori kreativ - një herë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Përfitimet për tregu i artit dhe sektori kreativ - në vazhdimësi | 3,000,000 | 3,300,000 | 3,630,000 | 3,993,000 | 4,392,000 | 4,831,000 | 5,314,000 | 5,845,000 | 6,430,000 | 7,073,000 |
| Përfitimet totale | 3,000,000 | 3,300,000 | 3,630,000 | 3,993,000 | 4,392,000 | 4,831,000 | 5,314,000 | 5,845,000 | 6,430,000 | 7,073,000 |
| Përfitimi i zbritur= Përfitimi në total x faktori zbritës | 2,857,000 | 2,993,100 | 3,136,100 | 3,285,000 | 3,440,000 | 3,603,000 | 3,777,000 | 3,955,000 | 4,139,000 | 4,342,000 |
| Vlera prezente aktuale e përfitimit në total | 36,530,000 | | | | | | | | | |
| Vlera prezente aktuale e kostos në total | 0 | | | | | | | | | |
| Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total | 36,530,000 | | | | | | | | | |

1. Kosto fiskale direkte për buxhetin e shtetit është zero, sepse Fondi financohet nga riallokimi i 10% të kursimeve nga prokurimet publike, pa shpenzime të reja buxhetore.
2. Përfitimet pasqyrojnë vlerën ekonomike të veprave të blera, rritjen e aktivitetit të tregut të artit, zgjerimin e koleksioneve publike dhe ndikimet indirekte në sektorin kreativ dhe kulturor.
3. Përllogaritja 10 vjeçare bazohet në një seri vjetore të qëndrueshme të përfitimeve monetare, pa aplikim të faktorëve të ndryshëm të rritjes ose skontimit, për qëllime krahasimore midis opsioneve.
4. Vlera neto pozitive (VAN) tregon se opsioni i krijimit të Fondit Kombëtar për Artin është ekonomikisht dhe socialisht i favorshëm në raport me status quo-në, duke gjeneruar përfitime neto për sektorin e artit dhe kulturës, për institucionet publike kulturore dhe për publikun e gjerë në afat të gjatë.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni (Te plotësohet nese informacioni është i mjaftueshem)

| Opsioni | Vlera aktuale në milionë lekë | | Vlera aktuale neto në milionë lekë |
|-----------|-------------------------------|-----------|------------------------------------|
| | Kosto | Përfitimi | |
| Opsioni 0 | 0 | 0 | 0 |
| Opsioni 2 | 0 | 36,530 | 36,530 |

MINISTËR

Blendi GONXHJA